



Since 1998
 Founded in Bucharest - Romania
 by KOPI KYÇYKU & ARDIAN KYÇYKU
 ISSN: 1454-1203
 ISSN electronic: 2069 – 153X

REVISTA HAEMUS

Felix qui potuit rerum cognoscere ca...

Home OnLine Ab Honores Premium Duo Publish Events Imago Video FaceBook Donatio Contact

SEARCH THIS BLOG

 Search

COPYRIGHT

No part of this blog posts may be reproduced without the written permission of the Publisher.

© A.C.A. Haemus

TEMA

Poezi/i (53)

Ese (44)

Haemus 45-50 (44)

Prosa (22)

Artikuj shkencorë (21)

Dixit (11)

Biseda (9)

Arte (5)

Articole științifice (5)

Fjalë të urta (4)

Theatrum (4)

Filocalia (3)

Librarium Haemus (3)

Proverbe (3)

Studime (3)

Clio (2)

De viris illustribus (2)

Haemus Plus 2011 (2)

Histori (2)

Humor (2)

Revista Haemus Nr. 36-40 (2)

Teatër (2)

Albania-România (1)

Algeria - trecut și prezent (1)

Bashkimi Evropian (1)

Botime (1)

Essentiis (1)

Fericeirea de a cunoaște Calea (1)

Haemus Plus 2012 (1)

Haemus Plus 2013 (1)

Haemus Plus II / 2013 (1)

Invidia (1)

Istorie (1)

Jehona e një dialogu

“Gjuha është një urë e padukshme dhe e mrekullueshme...” - Bisedë me botuesen Feride E. Berisha

Revista Haemus: Si lindi ideja për të themeluar shtëpinë botuese PA?

Feride E. Berisha: Në vitin 2011 në Gjermani doli një libër shumë i vogël, por shumë i rëndësishëm i autorit franko-gjerman Stéphane Hessel me titullin "Indinjohuni!". E lexova dhe më bëri aq shumë përshtypje, sa që besova se ky libër i nevojitej lexuesit shqiptar, prandaj i mora te drejtat nga botuesja franceze për ta nxjerr këtë libër në gjuhën shqipe. Mirpo, ngaqë nuk gjeta asnjë shtëpi botuese, që do ta botonte këtë libër, e themelova unë vetë një shtëpi botuese. *Pa* derë, *pa* kulm, *pa* mure, por me një vatër mu në mes të shtëpisë dhe me dëshirën e flaktë që të nxjerr "Indinjohuni! në shqip. I vura shtëpisë botuese emrin PA, sepse me të vërtetë, kur fillova me këtë zanat, pa asnjë ide, se si do të funksiononte; pa mjete financiare, pa përvojë apo dijeni se si bëhet kjo punë. Deri atëherë marrëdhënia e vetme me librin kish qenë leximi. Pra, të merrem drejtpërdrejt me librat, jo vetëm t'i lexoj ata, ka qenë me siguri një dëshirë e fshehtë e imja, e cila pahiri m'u realizua. Ishte, pra, një *rastësi me dashje. Për ata që se dinë, emri i shtëpisë botuese PA i ka vetëm dy shkronja, por është një fjalë.*

- Cilët janë synimet kryesore të kësaj shtëpie botuese?

- Natyrisht të botoj autorë të mirë! Të nxjerr libra të mirë, ndoshta edhe nga autorët jo fort "të përshtatshëm"... Po, një ndër synimet kryesore është që të arrij të nxjerr libra, që shtjellojnë disa tema pak më të papërpunuara deri më tani, ose fare pak në letërsinë shqipe. Sidomos të sjell në gjuhën shqipe një copë letërsie nga ajo letërsia e madhe gjermane. Gjithashtu, mendoj se ne si individë, pavarësisht në çfarë pune bëjmë, duhet të angazhohemi për një shoqëri më të mirë. Nuk mendoj se autorët do të duhet vetëm të ulen në karrige dhe të shkruajnë gjithë ditën e lume. Nëse shkruajnë romane fantastike, puna e mbarë ju qoftë. Por nëse mundohen të marrin tema nga e përditshmja, atëherë do të duhet patjetër të marrin më shumë pjesë dhe të angazhohen me kumtesa dhe shkresa të domosdoshme për ngjarjet reale në shoqëri. Mendoj se sidomos shkrimtarët duhet ta hapin gojën më shumë dhe të përfshihen më shumë në zhvillimet politiko-shoqërore. Autorët gjermanë, për shembull, edhe pse kanë pasur kushte më të mira pune, prapë se prapë nuk janë ndalur pa marrë pjesë në përditshmërinë e shoqërisë dhe nuk kanë hesitur dhe nuk heshtin.

- Disa nga botimet dhe autorët tuaj...

- Po edhe përzgjedhja e autorëve duket si një rastësi: disa kanë ardhur vetë tek shtëpia botuese, e disa i kam ftuar unë, kjo sa u përket autorëve shqiptarë. Ndërsa ata gjermanë, unë i zgjedh vetë nga ata më të rrallët, që kanë qenë më ndryshe se të tjerët. Kanë jetuar dhe shkruar më ndryshe nga e rëndomta. Nga autorët gjermanë, për shembull, dua të përmend Hans Falladën, një autor i spikatur gjerman, i cili veprën e tij të fundit "*Secili vdes vetëm për vetveten*" me vëllim prej 700 faqesh e shkruan në spital në ditët e fundit të jetës së tij brenda tri javësh. Kjo vepër është bestseller prej 60 vjetësh, dhe është e përkthyer në të gjitha gjuhët e mëdha të botës. Edhe në gjuhën shqipe, qysh në vitin 1969, nga shtëpia botuese Naim Frashëri, ndonëse nga çenzura e atëhershme librit i hahen gati 300 faqe. Ky autor ka shkruan për njeriun e thjeshtë, për njeriun e varur nga alkooli, për njeriun e varur nga substancat e ndryshme narkotike, për njeriun e varur nga duhani – e ai njeri është ai vetë. Fallada shkruan për përvojat e veta, dhe për këtë arsye ka hyrë në letërsinë e madhe botërore. Në shqip një vepër tjetër e këtij autori, e përkthyer nga unë: "*Tri vjet jo njeri*", PA 2013.

Blerina Rogova-Gaxha është ndër poetet e para shqiptare që me guximin e saj i futet poezisë me tema deri më tani "të burrave". Ndërsa në vëllimin e dytë të poezive të saj ajo kthehet më shumë kah problemet sociale të njeriut të sotëm dhe apostrofon gjendjen e graas në shoqërinë tonë. Muzika që e përcjell vargun e gjatë dhe të ri në poezinë moderne e bëjnë më të lexueshme dhe më të kuptueshme këtë poete. Shumë krenare jam, gjithashtu, që e kam nxjerrë si botim të ri poetin e papërsëritshëm Jamarbër Marko. Nga tematikat e veprave të botuara nga PA, duhet gjithsesi të përmendet "projekt et party" të autorit kosovar Beqë Cufaj. Ai vjen me shtjellimin e një teme gjithashtu të papërpunuar deri më tani në letërsinë shqipe – me neokolonializmin në botë, me vendngjarje në Kosovën e pasluftës në formë të re: të misioneve të huaja bamirëse. Kurrsesi nuk dua të harroj, apo të veçoj dikë, por autorët e PA, si Arif Molliqi, Gëzim Aliu,

shqiptaro-izraelit (1)
Karnavale (1)
Kaínas dhe Abelianë (1)
Kinematografi (1)
Medalion (1)
Mërgimi dhe gjuha e dytë e Ovidit (1)
Njeriu i ndërprerë (1)
Një pamje e Vendit të Shenjtë (1)
Nositë (1)
Occident (1)
Omul i ndërprerë (1)
Orient (1)
Parëvera në Transilvani (1)
Poeteka (1)
Portrete (1)
Primëvara in Transilvania (1)
Revista Haemus Nr. 30-31-32 (1)
Revista Haemus Nr. 41-44 (1)
Revista Haemus Nr. 45-50 (1)
Rumani (1)
Rumania (1)
Sahara (1)
Scurtë istorie a Azerbaidjanului (1)
Shqiptarët në Rumani e Bullgari (1)
Smira (1)
Toleranca (1)
Toleranța (1)
Treatru (1)
Turcia (1)
Vargje (1)
Venezia (1)
Zoti është lindur në mërgim (1)

ARKIVI

▼ 2015 (46)

► 04/12 (1)

► 03/08 (1)

▼ 03/01 (43)

GRIGOR SINAITI: Tre llojet e të shkruarit

Muri i Katërt... - Bisedë me artistët Albert Dedja d...

IULIA ENKELANA: A fost ca o piesă (Piesă într-un s...

MERITA TOÇILA: Lidhja e Artit me veshjen

SADEGH HEDAYAT: Perçja

ERMIR NIKA: Modernizmi si dukuri historike, kultur...

ALISA VELAJ: Metamorfozat e pafundme të qenësisë

BEQIR MUSLIU: Cronica Ioaninei (1350-1400), II Kro...

BARDHYL LONDO: Disidentji (Disidentët)

VIRION GRAÇI: Fenascon (Fenaskon)

AZIS GJERGJI: Legjitimiteti i

Manjola Brahaj janë një frymë e re dhe e bukur në letërsinë shqipe. Nga letërsia e huaj, si përmbledhje e kësaj që thash më parë, i kam nxjerrë gjashtë libra, pesë prej të cilëve janë bestsellerë botërorë dhe kam disa autorë shumë të mirë nga Shqipëria.

- *Vjen nga një zonë me shumë vuajtje dhe drama. Veç kësaj, të është dashur të njohësh dhe të përballosh mërgimin, vështirësitë e tij, derisa të gjesh vet veten...*

- Vij nga Kosova për shkaqe socio-politike të asaj kohe, jam e përplasur në Berlin dhe këtu tani mundohem t'i a gjej vetes një vend. Jetoj edhe në Prishtinë, por shumicën e kohës në Berlin, se këtu e kam familjen time. Mërgimi nga njëra anë është një vështirësi, apo një kafshatë e rëndë për t'u kapërdirë, por nga ana tjetër një mundësi. Është sikur të të gjuajë dikush në mes të oqeanit, dhe ti o do të notosh, o do të mbytesh. Pra, duhet ta përshtatësh veten tënde, në një shoqëri të re. Më është dashur të nxjerr nga xhepi i lekosur një *Unë* të ri, i cili do të përshtatej duke u përplasur në ndalesat dhe pengesat në rrethanat e reja. Mirpo gjuha është një urë e padukshme dhe e mrekullueshme. Ajo të bart, duke i depërtuar edhe muret.

Tek mësoja gjuhën gjermane, e mësoja edhe më mirë gjuhën shqipe. Fillova të lexoj dhe të kuptoj më shumë rrethin e ri. Jetën time të re, jetën gjermane. Duke i krahasuar këto dy gjuhë, njëra shumë e madhe e tjetra pak më e vogël, fillova të përkthej. Është një sfidë e Madhe që të përkthehet një gjuhë e madhe në një gjuhë të vogël. Por është një kënaqësi e pakrahasueshme me asgjë.

- *Kujtime nga jeta e dikurshme... Si ishte mjedisi dhe cilët ishin heronjtë e fëmënisë sate?*

- U rrita në një familje shumë të gjerë, ishim tetë fëmijë. Secili i ndryshëm nga tjetri. Ishte një familje me qëndrime të qarta politike, asnjëri nga ne nuk u fut në partinë e atëhershme komuniste të Jugosllavisë, për të bërë karrierë të bujshme. U rrita në një vend të pushtuar, dhe kjo ndjehej tërë kohën. Hero në fëmijërinë time ishte Daja Hasan, një burrë shumë i mençur, që i fliste rrjedhshëm pesë gjuhë të huaja. Ai ka qenë një personazh, si mund të përshkruhet një burrë i mirë, që e përplasën fatet prej Kosovës, në Gjermaninë naziste, ku, i zënë rob lufte, shërbeu pesë vite si punëtor i detyrueshëm, siç thoshte ai vetë, angari. Pastaj kthehet në Kosovë me vizione dhe vullnet për ta ndërtuar një shoqëri të mirë dhe të re. Burgoset nga regjimi i ish-Jugosllavisë, si kundërshtar i aneksimit të Kosovës nga Jugosllavia. I thyer dhe i sëmurë, pas pesë vitesh burg të rëndë, shpërngulet në Bosnjë, ku martohet dhe krijon familje. Ishte tepër i zoti, na tregonte shumë përralla, të cilat më kanë përcjellë dhe formuar gjatë gjithë fëmijërisë sime. Njëri nga vëllezërit e mi është diplomuar me këto përralla në Letërsinë gojore shqipe. Daja Hasan, për të ma bërë qejfin, nganjëherë shkruante shqip me alfabetin cirilik, ndërsa nganjëherë shkruante sërbsisht me alfabetin arab. Ishte tepër i formuar, por ai u rreshtua në anën e të papërshtatshmëve, atyre të përndjekurve dhe të shtypurve. Gjithashtu, heronj për mua kanë qenë dhe kanë mbetur prindërit e mi, të cilët ishin vetë, me pak ose pa shkollë, ndërsa ne fëmijëve na rritën dhe na edukuan në një frymë, që të mos e ndërrojmë mendjen kah të fryjë era.

- *Si ishte takimi yt i parë me Shqipërinë?*

- Në Shqipëri për herë të parë kam qenë me familjen time në vitin 2000. Së pari nuk e besoja se po e shkeli tokën që për neve shqiptarët e Kosovës ka qenë e Shenjtë. Posa hymë në Kukës, dikush ia theu xhamat autobusit me gurë. Pak frikë, por më shumë kurrështje. Isha shumë e lumtur, kisha shumë pritje të mëdha, shumë paragjykime, disa nga të cilat më janë varrosur menjëherë. Mirpo vizitën time e përsërita edhe shumë herë më vonë, me familjen time të re, dhe shumë herë jam kënaqur me miq të rinj, me mikpritjen shqiptare, me ushqimin e kurrështjes ndaj historisë së Shqipërisë, me bregdetin shqiptar, me qytetet historike. Me tregimet personale të shumë njerëzve, që e kanë pasur fatin e zi të jenë të persekutuar nga regjimi i atëhershëm enverist.

Në Shqipëri mund të kënaqesh sa të duash, por kurrë të mos ngjesh.

- *Cila ka qënë përvoja jote si mërgimtare?*

- Unë hyra pa leje, në këmbë, në Gjermani dhe mendoja se po shkoja në vendin e Hegel-it dhe të Kant-it. Takimi i parë ishte merrues dhe shokues, sepse policia kufitare gjermane na zuri sapo kaluam malin dhe neve si refugjatë na hodhën në burg dhe, pas dy ditësh, na kthyen pastaj prapë ne Çeki. Por jo para se policët të na plaçkisnin në burg, ku na morën të holla, sa deshën, ose sa kishim me vete. Pastaj, me orvatjen e dytë, u futa në këtë vend, që nuk i donte të huajt. Pra, u mësova me jetu, pa asnjë drejtë. Ishte politika e ditës në atë kohë. Nuk kishim asnjë të drejtë, as për të punuar, as për të jetuar nëpër banesa normale, e as për të shkuar në shkollë. Ishim të detyruar të jetojmë nëpër ish-barakat e kampeve të përqendrimit, të mbetura nga Lufta e Dytë Botërore. Por ishin fëmijët që më shpejt filluan të integroheshin, dhe unë nisa të mësoja gjermanishten, dhe kjo ma shpëtoi dinjitetin e njeriut. Vetëm pas tri viteve fillova të përktheja në gjykatë dhe gjeta një punë si ndihmëse në çështjet sociale. Për disa vjet kam punuar pranë Senatit të Berlinit në politikën e zhvillimit të qytetit. Unë disa kam depërtuar, por shumë të tjerë janë vyshkur, nuk kanë më shpresa dhe janë në depresione të thella.

Tani më duket se jam kthyer prapë në atdhe, duke u marrë me përkthime dhe duke botuar libra. Pra, e kam gjetur atë urën (gjuhën) që më pat qitur në anën tjetër të lumit, dhe tash, siduket, po kthehem prapë andej nga kam ardhur.

- *Çfarë përfaqëson hapësira gjermane për ty?*

- Tash qe disa vite e kam marrë edhe nënshtetësinë e këtij shteti, im shoq është gjerman, por unë nuk mund të them se jam gjermane. Nuk e di edhe sa kohë do të kalojë, por këtu do të më pyesin gjithmonë se nga vij? Pra, edhe po të ndjehesh se ke zënë vend, dhe se askund në botë nuk je më rehat se në shtëpinë tënde në Berlin, prapë dikush në përditshmëri ta përkujton se nuk je nga / që këtu. Por prapë po e përsëris: është gjuha ku jetoj unë, e jo vendi. Letërsia gjermane është aq e madhe, aq e gjerë, saqë do të më nevojiteshin pa dyshim edhe disa jetë që të mund të lëvroja më thellë në këtë arë. Berlini është kontradiktë në vete: Teksa ka vend për shumë krijues dhe i frymëzon, mundet edhe të jetë i vrazhdë dhe armiqësor. Por a nuk është kontradiktë trualli ku lindin gjërat më të mira?

- *Lidhjet e hershme dhe të tanishme me botën shqiptolëse...*